



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:077572

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697475

KPPP.nr. 457/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë–Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kundër debitorit “Kompania Ujësjiellësi Rajonal Prishtina” SH.A., me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala” nr.4, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 53/2024 të datës 28.02.2024, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Dritan Govori, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Kompania Ujësjiellësi Rajonal Prishtina” SH.A., ndërsa Urdhri Përmbaremore P.nr. 53/2024 i datës 28.02.2024, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Dritan Govori, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë–Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bazë të dokumentit përmbareues - Vendimit Nr.01/56-278/23-GJ i datës 24.10.2023 ka caktuar zbatimin e përmbaremit përmes urdhrit përmbaremore P.nr.53/2024 të datës 28.02.2024 ndaj debitorit “Kompania Ujësjiellësi Rajonal Prishtina” Sh.a., të cilin e ka detyruar që në emër të masës ndëshkimore të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 1,000.00 EUR, në afat prej 7 ditësh nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe në shitje të sendeve të luajshme pronë e debitorit, si dhe t’i paguajë shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se nuk është respektuar forma e paraparë ligjore, rrjedhimisht nuk ka urdhër të vlefshëm, sepse nuk i është bashkëngjitur Urdhri për lejimin e përmbartimit si akt juridik i veçantë, ashtu siç është përcaktuar me ligj. Pastaj dokumenti përmbartues me të cilin është iniciuar procedura përmbartimore nuk e ka klauzolën e përmbartueshmërisë, e po ashtu nuk është e qartë se a është bërë e kërkueshme kërkesa e kreditorit, dhe përmbartimi nuk ka mundur të fillojë përderisa kreditori nuk ka paraqitur deklaratë me shkrim konform dispozitave të LPP-së. Debitori ka theksuar edhe se brenda afatit të caktuar kohor ka ushtruar padë për hapjen e konfliktit administrativ me kërkesë për masën e sigurimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, dhe ta shfuqizoj Urdhrin për Përmbartim P.nr. 160/17 të datës 28.12.2017.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, dhe se propozimi për përmbartim është parashtruar si rezultat i mos pagesës së detyrimeve nga ana e debitorit në mënyrë vullnetare. Po ashtu ka theksuar se Vendimi me Nr.01/56-278/2023-GJ i datës 24.10.2023 është i besueshëm, i përmbartueshëm dhe i ekzekutueshëm. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi Urdhrin për Përmbartim P.nr. 53/2024 të datës 28.02.2024 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Driton Govori.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Vendimin Nr. 01/56-278/2023-GJ të datës 24.10.2023, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti*

përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se Vendimi Nr. 01/56-278/2023-GJ i datës 24.10.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”,* ngase aktvendimi i lartcekur është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë nga e cila rezulton se i njëjti është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 28.12.2023.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Pretendimet se ndaj vendimit të lartcekur ka parashtruar padi në procedurën e konfliktit administrativ gjykata i vlerësoi si të pabazuara ngase padia e paraqitur në gjykatë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e vendimit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, kjo në kuptim edhe të dispozitës nga neni 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me të cilin përcaktohet se *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”.*

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 457/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

Numri i lëndës: 2024:077572
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05697475

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.